



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 46, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“KOMPLEKS TURISTIK “HOTEL PALACE”


Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Amadeus Palace” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Kompleks turistik “Hotel Palace”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Amadeus Palace” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 07.03.2014, nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

